



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës  
Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

---

Nr.21/19

Datë: **23 Maj 2019**

Duke u bazuar në nenin 28, 29, 35 paragrafi (1), neni 54 paragrafi (1) nën-paragrafi 1.9, dhe nenit 66 i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 03/L-229 (Gazeta zyrtare nr.88/25), dhe Ligji Nr. 04/L-226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, duke u bazuar në shqetësimet e ngritura nga Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë z. Uran Ismaili, reagimet e mediave lidhur me tenderin e MSH-së për Furnizim me cito statik nga Lista Esenciale për barin Imatinib Mesylate 400 mg - mbi dyshimet për çmimet e larta krahasuar me çmimet e tregut, pas shqyrtimit të Raportit të Sekretariatit, Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës në mbledhjen e mbajtur me **23.05.2019**, merr këtë:

**VENDIM**

- I.** Mbyllet procedura hetimore ndaj ndërmarrjeve: **Ntsh “Redoni H M”, “Exclusive Corporation” Shpk dhe “Exclusive” Shpk**, e hapur me Konkluzionin Nr. 31/18 i dt. 04.05.2018.
- II.** Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës konstaton se nuk ka dëshmi se ndërmarrjet nën hetim kanë bërë kurdisje të ofertave në tenderët e Ministrisë së Shëndetësisë për furnizim me barna nga Lista Esenciale - bari Imatinib Mesylate 400 mg.
- III.** Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Komisioni.

**ARSYETIM**

---

1. Procedurën e konstatimit të marrëveshjeve të ndaluara nga neni 4 i këtij ligji, Autoriteti e fillon sipas detyrës zyrtare.
2. Autoritetit pas shqetësimeve të ngritura nga Ministri dhe reagimit të mediave ka filluar trajtimin e rastit sipas detyrës zyrtare. Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë z. Uran Ismaili, ka njoftuar Autoritetin e Konkurrencës për dyshimet e tij mbi tenderin e MSH-së “Furnizim me Cito statik nga Lista Esenciale” Llot 17, me Ref: 206-17-3219.111, me dyshim për kufizim të konkurrencës me marrëveshje të ndaluara nga ndërmarrjet në procesin e prokurimit në Ministrinë e Shëndetësisë.
3. Autoriteti, pas shqyrtimit paraprak të hetimit ka ardhur në përfundim se ka dyshime për marrëveshje të fshehtë në mes të ofertuesve dhe se duhet filluar procedurat hetimore për tenderët e Ministrisë së

Shëndetësisë respektivisht kontratat, aneks kontrata publike kornizë të MSH-së për furnizim me cito statik respektivisht Llotet e përcaktuara ndër vite në tenderët për barin Imatinib Mesylate 400 mg, siç janë:

1. Kontrata me Ref: 206/011//098/111 – Lloti 6.
2. Kontrata me Ref: 206/011//098/111 – Lloti 6 – Aneks Kontratë për kontratat publike kornizë.
3. Kontrata me Ref: 206/16/003/111 – Lloti 10.
4. Draft Kontrata me Ref: 206/017/030/111 – Lloti 17.

## **PROCEDURA E NDJEKUR NGA AUTORITETI**

1. Për t'i vërtetuar pretendime e veta, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës duke u bazuar në nenin 35 dhe 36 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ka hapur procedurë hetimore me Konkluzion Nr. 31/18 i dt. 04.05.2018 ndaj ndërmarrjeve: “Ntsh “Redoni H M”, “Exclusive Corporation” Shpk dhe “Exclusive” Shpk.
2. Gjatë periudhës hetimore kemi mbajtur takime me zyrtar të MSH-së. Nga këta takime kemi kërkuar që të na informojnë mbi procedurat e prokurimit për furnizim nga Lista Esenciale e barnave konkretisht bari Imatinib Mesylate 400 mg si dhe kemi kërkuar dokumentacionet e nevojshme për analizim dhe vlerësim të rastit.
3. Më datë 02.11.2017 zyrtarët e Autoritetit kanë dalur në terren për të hulumtuar tregun lidhur me çmimet e tregut për barin Imatinib Mesylate 400mg.
4. Me datën 10.01.2018 Autoriteti ka kërkuar nga SHSKUK që të na sigurojë dokumentacionin për vlerësim, si: Kontratën për Llotin e caktuar të tenderit për furnizim me barin Imatinib Mesylate 400 mg për vitin 2015; Kërkesën për furnizim nga Autoriteti kontraktues dhe Faturat (*komplet lënda që është paguar nga zyra e financave të SHSKUK-së*) e furnizimeve për barin Imatinib Mesylate 400 mg për vitin 2015 dhe 2016 nga kompania kontraktuese; Numri i sasisë së furnizuar nga operatori ekonomik të pranuar nga autoriteti kontraktues për vitet 2015 dhe 2016.
5. Me datën 24.04.2018 zyrtarët e Autoritetit kanë marrë pjesë si vëzhgues në seancën e Organit Shqyrues të Prokurimit lidhur me shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik Ntsh Redoni H M kundër vendimit për anulim të Ministrisë së Shëndetësisë për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me Cito statik” nga Lot.17 me nr. prokurimi 206/17/3219/111.
6. Zyrtarë e Autoritetit gjatë muajve Korrik dhe Gusht 2018 ka mbajtur takime për marrjen e informatave në zyre e AKK-së me përfaqësuesit e palëve në procedurë.
7. Me datën 16.08.2018 zyrtarët e Autoritetit kanë mbajtur takim në Agjencinë për Produkte dhe Paisje Medicinale me zyrtarë të Departamentit të Licencimit, tema e takimit ishte marrja e informatava lidhur me rastin. Nga ky takim kemi kërkuar dokumentacionin e ndërmarrjeve që janë të licencuara për import të barit Imatinib Mesylate 400 mg.
8. Me datën 17.08.2018 kemi mbajtur takim në Policinë e Kosovës respektivisht Departamentin për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit.

9. Me datën 12.09.2018 ju kemi drejtuar ATK-së, me kërkesë për marrjen informatave për përmbledhjen e të dhënave për të gjithë të punësuarit e paraqitur në ATK të ndërmarrjeve nën hetim.
10. Me datën 12.09.2018 Autoriteti me shkresë ka kërkuar nga Fondi Pensional i Kosovës - TRUST, mbi përmbledhjen e bilancit të kursimeve pensionale dhe detajet e transaksionit për të gjithë të punësuarit të paraqitur në TRUST të ndërmarrjeve nën hetim.
11. Kërkesa nga Dogana e Kosovës për informata mbi importet e ndërmarrjeve nën hetim.

## **PRETENDIMET E AUTORITETIT**

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës me datë 4 maj 2018 ka marrë Konkluzion Nr. 31/18 për fillimin e procedurës hetimore ndaj: 1. Ntsh Redoni H M. 2. Exclusive Corporation Shpk. 3. Exclusive Shpk, për shkak të dyshimit për marrëveshje të ndaluar ose praktikave të bashkërenduara në kuptim të nenit 4 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 03/L-229, në proceset tenderuese të Ministrisë së Shëndetësisë, për barin Imatinib Mesylate 400 mg.

## **PALËT NË PROCEDURË**

1. Duke i'u referuar Konkluzionit Nr. 31/18 të Komisionit të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, të datës 04.05.2018, palë në procedurë janë:
  - a. Ntsh "Redoni H M" - Nr. Regj. biznesit: 70595451, Adresa: Rr. Behar Begolli PN, Prishtinë.
  - b. "Exclusive Corporation" Shpk - Nr. Regj. biznesit: 810035495, Adresa: Hilmi Rakovica, Nr. 43, Prishtinë.
  - c. "Exclusive" Shpk - Nr. Regj. biznesit: 7047927, Adresa: Abdullah Tahiri PN, Prishtinë.
2. Objekti i hetimit janë marrëveshje e ndaluara në mes të ofertuesve për tenderët e Ministrisë së Shëndetësisë respektivisht kontratat, aneks kontrata publike kornizë të MSH-së për furnizim me citostatik gjegjësisht Llotet e përcaktuara ndër vite në tenderët për barin Imatinib Mesylate 400 mg, siç janë:
  - Kontrata me Ref: 206/011//098/111 – Lloti 6.
  - Kontrata me Ref: 206/011//098/111 – Lloti 6 – (Aneks Kontratë për kontratat publike kornizë).
  - Kontrata me Ref: 206/16/003/111 – Lloti 10.
  - Draft Kontrata (e pa nënshkruar) me Ref: 206/017/030/111 – Lloti 17.

## **PËRCAKTIMI I TREGUT RELEVANT**

### **1. Tregu përkatës apo relevant**

Tregu gjeografik - duke iu referuar nenit 6 të Udhëzimit Administrativ për mënyrën dhe kriteret e përcaktimit të tregut përkatës Nr. 02/2018, bazuar në analizën e këtij rasti, tregu gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Kosovës.

### **2. Tregu i produktit është:**

Tregu Farmaceutik në vend përkatësisht produkti apo bari Imatinib Mesylate 400 mg. Ky bari bënë pjesë në grupin e Cito statikëve në Listën e Barnave Esenciale, i cili përcaktohet si Imatinib Mesylate 400 mg në specifikacionet e tenderëve të Ministrisë së Shëndetësisë.

## ANALIZA E KONKURENCËS

---

1. Për të analizuar rastin nga këndvështrimi i rregullave të Konkurrencës, Autoriteti ka trajtuar rastin në kuptim të nenit Nenin 4 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës “Marrëveshje të Ndaluar” për të vërtetuar nëse ka pasur manipulim të ofertave (BIDRIGGING), konkretisht nëse ndërmarrjet kanë zbatuar parimin e Rotacionit (BidRotation) për të fituar kontratat në tenderët publik në Ministrinë e Shëndetësisë.
2. Marrëveshjet e ndaluara në oferta ndodhin kur ndërmarrjet (operatorët ekonomik), të cilët supozohet të konkurrojnë, në mënyrë të fshehtë bien dakord për rritjen e çmimeve ose uljen e cilësisë së produkteve (të mirave apo shërbimeve) për blerësit (autoritetet kontraktore), të cilët dëshirojnë të sigurojnë produktet dhe shërbimet nëpërmjet një procesi prokurimi. Institucionet publike dhe private shpesh mbështeten në një proces konkurrues ofertash për të realizuar një përdorim sa më të mirë të parasë. Një proces konkurrues mund të sigurojë çmime të ulëta apo cilësi më të mirë dhe ndryshim (risi) vetëm nëse ndërmarrjet (operatorët ekonomik) konkurrojnë me të vërtetë (vendosin kushtet dhe kriteret e tyre me ndershmëri dhe në mënyrë të pavarur). Marrëveshjet e ndaluara në oferta mund të bëhen në veçanti të dëmshme, nëse ato prekin prokurimet publike. Këto marrëveshje sjellin pasoja për blerësit dhe taksapaguesit, ulin besimin publik në një proces konkurrues dhe zvogëlojnë përfitimet nga një treg konkurrues.
3. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës sipas Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, neni 66: “Zbatimi i këtij ligji duhet të jetë në pajtim me direktivat e Bashkimit Evropian” andaj kemi konsultuar Udhëzuesin e OECD-së “Mbi luftimin e marrëveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike” për të vërtetuar nëse ndërmarrjet nën hetim kanë përdorur parimin e Rotacionit për të fituar tenderët për furnizim me barna nga Lista Esenciale për barin Imatinib Mesylate 400 mg në Ministrinë e Shëndetësisë. Sipas këtij udhëzuesi të OECD-së, në skemat e parimit të rotacionit të ofertave, ndërmarrjet e përfshira në kurdije/manipulim të ofertave merren vesh që të konkurrojnë por njëra të tërhiqet nga të qenurit fitues i tenderit (zakonisht ofertuesi me çmimin më të ulët, i cili këtë herë ta lëshoj radhën ndërmarrjes tjetër), P.sh: - pjesëmarrësit në marrëveshje mund të zgjedhin të ndajnë me përafërsi volume vlerash monetare të barabarta për grupe të caktuara kontratash për secilën ndërmarrje, ose të ndajnë volume që korrespondojnë me madhësinë e çdo ndërmarrjeje.
4. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës ka përdorur metodën OECD-së, për të hulumtuar prokurimet publike të këtyre kontratave në Ministrinë e Shëndetësisë, ndër format më të njohura të marrëveshjeve në oferta në prokurim publik, mënyrat se si ofertuesit bien dakord të eliminojnë konkurrencën, indikatorët e marrëveshjeve në oferta, listën e karakteristikave që ndihmojnë marrëveshjen, reduktimin e koordinimit të sjelljes në procesin e prokurimeve, risku i tenderimeve në marrëveshje, etj. Bazuar në këtë metodologji është **vlerësuar sjellja** e operatorëve ekonomik (ofertuesve) të cilët kishin ofertuar në Ministrinë e Shëndetësisë nga operatorët ekonomik “Ntsh “Redoni H M”, “Exclusive Corporation” Shpk dhe “Exclusive” Shpk.
5. Ndërmarrja Exclusive Shpk produktin Imatinib Mesylate 400 mg e ka shitur me çmim të cilin e ka kontraktuar me Ministrinë e Shëndetësisë, ndërsa pas skadimit të kontratës me këtë institucion produktin e lartë cekur ka shitur me çmim më të lirë, sipas deklaramentit të përfaqësuesve të

ndërmarrjes Exclusive Shpk arsyeja e uljes së çmimit ka qenë për shkakun se: produktet farmaceutike e kanë afatin e skadimi 1-3 vjet, ndërsa bari Imatinib Mesylate 400 mg ka afat 3-5 vjet, e kjo ka rëndësi në çmim, sepse kompanitë farmaceutike vlerësojnë se ma ekonomike është që të shesim produktin me çmim më të ulët se sa me shkatërruar, ngase kostoja e shkatërrimit është më e madhe.

6. Ndërsa ndërmarrja Ntsh "Redoni H M", produktin Imatinib mesylate 400 mg nuk e ka shitur me pakicë por vetëm me shumicë në ato institucione me të cilat ka pas kontratë.
7. Autoriteti i Konkurrencës në tenderin për furnizim nga lista esenciale e barnave për barin Imatinib Mesylate 400 mg ka konstatuar se ndërmarrjet nuk kanë fituar tender të përafërt për nga sasia dhe çmimi, sipas çmimit dhe sasisë nuk është e përafërt për të konstatuar se kompanitë janë koordinuar, ndonëse në dukje të parë kemi radhitje të fitimit të tenderëve në Ministrinë e Shëndetësisë, por arsyetimi ekonomik nuk përputhet me qëllimin sepse po të ishte duke u zbatuar parimi i rotacionit do të ishte përputhur çmimi i kontratave dhe sasia e furnizimit.
8. Autoriteti ka evidentuar faktin se ndërmarrjet gjatë proceseve tenderuese në Ministrinë e Shëndetësisë kanë parashtruar ankesa të ndryshme brenda Ministrisë, Organit Shqyrtues të Prokurimit dhe me Padi në Gjykatën Themelore.
9. Autoriteti, gjatë procedurës hetimore kundër ndërmarrjeve Ntsh Redoni H M, Exclusive Corporation Shpk, Exclusive Shpk ka zhvilluar aktivitete me kërkesa të ndryshme në institucione, nga palët në procedurë dhe palë tjera me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike në procesin e tenderimit për barin Imatinib Mesylate 400 mg në Ministrinë e Shëndetësisë. Është kërkuar nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës, regjistri i nëpunësve të paraqitur në TRUST i ndërmarrjeve nën hetim, për të vërtetuar nëse ndonjë punëtor i tyre në të kaluarën ka punuar në ndërmarrjet respektive, po ashtu edhe nga ATK-ja është dërguar e njëjta kërkesë.
10. Gjatë analizimit dhe verifikimit të të dhënave nga TRUST-i dhe ATK-ja kemi vërtetuar se nuk ka pas ndonjë person i cili ka pas shkëmbim të punëtorëve të ndërmarrjeve e as ndonjë pikë përbashkësie në mes tyre.
11. Autoriteti ka kontrolluar/verifikuar llogarit bankare të ndërmarrjeve Ntsh "Redoni H M", "Exclusive" Shpk dhe Exclusive Corporation Shpk në bankat: Raiffeisen Bank në periudhën 01.01.2014 deri më datën 31.12.2017, NLB Bank në periudhën 01.01.2014 deri më 29.08.2018 dhe Banka Kombëtare Tregtare (BKT) në periudhën 01.01.2014 deri më 29.08.2018. Nga analiza dhe verifikimi i këtyre të dhënave nuk është gjetur ndonjë transaksion nga llogarit bankare në mes të ndërmarrjeve nën hetim.
12. Autoriteti, po ashtu ka verifikuar librat blerës dhe shitës të ndërmarrjeve nën hetim dhe në bazë të analizës dhe vërtetimit të gjendjes faktike në libra nuk ka hasur ndonjë shitë blerje ndërmjet ndërmarrjeve nën hetim.

Andaj për nga sa u tha më lartë lidhur me çështjen, Komisioni vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

**Këshilla juridike:** Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa por pala me padi mund të iniciojë konflikt administrativ pranë gjykatës kompetente për çështje administrative.

**AUTORITETI KOSOVAR I KONKURENCËS**

**KOMISIONI**

\_\_\_\_\_  
Valon PRESTRESHI  
Kryetar

\_\_\_\_\_  
Ahmet KRASNIQI  
Zv. Kryetar

\_\_\_\_\_  
Fatime S. HAZIRI  
Anëtare

\_\_\_\_\_  
Muhamed KRASNIQI  
Anëtarë

\_\_\_\_\_  
Shaqir MORINA  
Anëtarë

Me këtë Vendim të njoftohen:

- *Arhiva*
- *Ntsh Redoni H M*
- *Exclusive Shpk*
- *Exclusive Corporation Shpk*